

Kodi për Barazi Gjinore

Politikat e ACER për Barazinë Gjinore

POLITIKA E PËRGJITHSHME

ACER do të jetë një vend pune me mundësi të barabarta, ku të gjithë punonjësit, pavarësisht moshës, gjinisë, besimeve fetare ose besimeve të tjera, etnisë, aftësive, identitetit apo orientimit seksual, do të kenë mundësinë të përparojnë dhe të zhvillohen profesionalisht.

Në planifikim dhe marrje vendimesh, ACER do të marrë parasysh ndikimin në barazi dhe diversitetet. Puna për barazinë gjinore është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të punës në ACER dhe duhet të integrohet në operacionet e përditshme.

Përpjekjet për promovimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta do të realizohen në bashkëpunim me punonjësit dhe partnerët. Asnjë person në ACER nuk duhet të ndihet i diskriminuar, dhe organizata do të lehtësojë një balancë të shëndetshme midis kohës së punës dhe asaj personale për punonjësit.

PUNËSIMI DHE PRINDËRIMI

ACER do të krijojë kushte që mundësojnë të gjithë punonjësit të kombinojnë punën me jetën familjare dhe do të inkurajojë të gjithë prindërit të ushtrojnë të drejtën e pushimit të prindërimit.

PARANDALIMI I NGACMIMEVE

Ngacmimi është i definuar si sjellje e padëshiruar bazuar në gjini ose sjellje e padëshiruar e natyrës seksuale që dëmton integritetin e punonjësit në vendin e punës. ACER ka një politikë zero-tolerancë për çdo formë ngacmimi seksual ose ngacmimi bazuar në gjini, etni, ose fe.

REKRUTIMI

Vlerësimet bazuar në aftësitë dhe përvojën do të formojnë bazën për rekrutimin dhe promovimin. Do të ndiqet një balancë gjinore, me qëllim përfaqësimin e barabartë të të dyja gjinive kudo që të jetë e mundur.

PAGESAT

Pagesat janë të bazuara në kritere të përgjithshme si rolet dhe përgjegjësitë brenda ACER, si dhe njohuritë dhe përvojën që lidhen me organizatën. Procesi i rishikimit të pagave do të jetë i barabartë për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga gjinia ose karakteristika të tjera.

Çdo kategori e stafit do të vlerësohet sipas kriterëve të saj dhe pritshmëritë për secilën kategori do të përshkruhen në përshkrimet përkatëse të punës.